



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit Odeljenje za Obrazovanje Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVËS,  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje

## Raport vjetor i punës

Nr. i prot. 997 Mb. 05.12.2025 (Janar – Dhjetor) 2025  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Gjatë vitit 2025 në kuadër të DKA-së u realizuan punë dhe aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin sipas Planit Vjetor të Punës për këtë vit. Këto punë dhe aktivitete të zhvilluara po i paraqesim të shkruara sipas katër periudhave tremujore, siç vijon:

### Tremujori i parë

- Është bërë Plani i Menaxhimit për kontratën e projektit “Digjitalizimi dhe audio – vizualizimi i materialeve mësimore në SHIFMU –të e komunës së Rahovecit.
- Kemi pranuar furnizimet e radhës me pako pedagogjike për mësimdhënësit e të gjitha niveleve. Kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin “Instalimi dhe montimi i kamerave të sigurisë në objekte publike” e po ashtu, kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin “Furnizimi me material teknik”.
- Kemi filluar përgatitjen e paramasave për projektin e ndërtimit të rrethojave të oborreve të shkollave.
- Janë mbajtur Garat Shtetërore të Fizikës, ndërsa procesi mësimor i filluar më 8 janar 2025 në gjysmëvjetorin e dytë u zhvillua normalisht.
- Kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin “Furnizimi me material higjieniko sanitar i shkollave” dhe “montimi i kamerave të sigurisë në objekte publike”.
- Është mbajtur një sesion informues për mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të Testit ndërkombëtar PISA.
- Në projektet kapitale, kanë rifilluar punimet në ndërtimin e objektit të SHIFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxë.
- Janë mbajtur ligjërata nga Policia e Komunitetit për nxënësit e shkollave fillore me temë “Siguria në komunikacion dhe rregullat e qarkullimit”.
- Kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin “Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarise dhe makinerise në hapësirat e jashtme dhe të brendshme në institucionet publike” dhe “Rregullimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektrike në institucionet publike”, e po ashtu, kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin e ndërtimit të rrethojave të oborreve të shkollave.

- Në kuadrin e projektit të riparimeve punime janë zhvilluar në riparimin e kulmit të shkollës “Nesimi Elshani” në Nagavc dhe riparimi i nyjeve sanitare në shkollën “Katër Dëshmorët” në Ratkoc.
- Mbajtëm sesionin informues me mësues të programit fillor për fillimin e zbatimit të projektit “Digjitalizimi dhe vizualizimi i materialeve mësimore”.
- Në projektet kapitale, kanë vazhduar punimet në ndërtimin e objektit të SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxë, ndërsa në SIIFMU “Katër Dëshmorët” janë zhvilluar punime në lyerjen dhe fasadimin e mureve të brendshme, dhe ndërkohë janë bërë përgatitjet për fillimin e fasadimit në pjesën e përparme të objektit. Punime janë zhvilluar edhe në ndërtimin e objektit të SHFMU “Milaim Krasniqi” në Pastascl, ku është bërë ndërtimi i mureve të ndarjeve të brendshme. Punime janë zhvilluar edhe në ndërtimin e Çerdhes për Fëmijë në Lagjen e Epërme të qytetit.
- Në kuadrin e projektit të riparimeve, punime janë zhvilluar në riparimin e disa elementeve të nyjeve sanitare të shkollave.
- Kanë vazhduar të mbahen ligjëratat nga Policia e Komunitetit për nxënësit e shkollave fillore dhe gjatë këtij muaji është trajtuar tema e shumëllojshmërisë së shoqërisë dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.
- Zhvilluam aktivitetin festiv për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe filluam me aplikimin e digjitalizimit të materialeve mësimore me mësime të mësimdhënësve të programit fillor.
- Zhvilluam edhe sesionin e dytë informues për digjitalizimin e materialeve mësimore, kësaj radhe me mësime të mësimdhënësve të ciklit të lartë (klasat 6 deri 9) dhe me këtë përmbajtje ciklin e informimit të mësimeve të lidhur me mënyrat e logimit (qasjes) dhe përmbajtjet e materialeve mësimore të digjitalizuara.
- Zhvilluam garat shkollore dhe kemi bërë përgatitjet për mbajtjen e garës komunale, të vlefshme për Olimpiadën e Kimisë me nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta.
- Është hapur konkursi për ndarjen e bursave për studentët dhe nxënësit dhe është zhvilluar intervistimi i kandidatëve për drejtorë shkollash në katër shkolla.
- Mbajtëm garën komunale të vlefshme për Olimpiadën e Kimisë me nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta.

### **Tremujori i dytë**

- Ka vazhduar aplikimi i studentëve dhe nxënësve në konkursin për ndarjen e bursave. Afati i aplikimit vazhdoi deri më 25 prill 2025;
- Në projektet kapitale, në SIIFMU “Katër Dëshmorët” kanë vazhduar punët në lyerjen dhe fasadimin e mureve të brendshme, për të vazhduar pastaj në fasadimin e jashtëm të pjesës së përparme të objektit.

- Kanë vazhduar të mbahen ligjërata nga Policia e Komunitetit për nxënësit e shkollave fillore në një temë tjetër të planifikuar për muajin prill, pasi që procesi mësimor rifilloi më 14 prill 2025, pas pushimit të pranverës.
- Të shtunën, më 19 prill u mbajt Gara Regjionale e Olimpiadës së Kimisë, ku morën pjesë nxënësit tanë fitues të Garës Komunale;
- Në projektet kapitale, në SHFMU “Katër Dëshmorët” pas përfundimit të dyshemeve të korridoreve dhe klasave, kanë vazhduar punët në lypcjen dhe fasadimin e mureve të brendshme;
- Është lidhur kontrata për projektin “Rregullimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektrike në hapësirat e brendshme dhe të jashtme në institucionet publike”;
- U zhvilluan aktivitete pastrimi me nxënës dhe mësimitdhënës për nder të Ditës së Tokës;
- U shënuan Dita e Shkollës në SHFMU “Nesimi Elshani” në Nagac;
- Ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë në objektin e SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec;
- Kanë vazhduar të mbahen ligjërata nga Policia e Komunitetit për nxënësit e shkollave fillore sipas planifikimit, edhe për muajin maj dhe kemi pranuar raportin e mbajtjes së ligjëratave për këtë muaj;
- U shënuan Dita e Shkollës në SHFMU “Teronjtë e Kosovës”, në SHFMU “Faik Konica” dhe në IAAP “Selajdin Mullaabazi-Mici”;
- Ka filluar dhe ka vazhduar të mbahet Testi Ndërkombëtar PISA me nxënësit 15 vjeçarë;
- U mbajt trajnimi për kodimin në shkollën me SHPIK-un me mësimitdhënësit klasorë;
- U shënuan Dita e Shkollës në SHFMU “Skënder Kastrati”, në SHFMU “Bajram Curri” dhe në SHFMU “Rilindja”;
- Më 15 maj përfundoi gjysmëvjetori i dytë për nxënësit maturantë në 3 SHMTL-të dhe në IAAP.
- Në projektet kapitale, në SHFMU “Katër Dëshmorët” kanë vazhduar punimet në izolimin me material izolues dhe fasadimin e pjesës së përparme të objektit me tulla njëshe;
- Ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë në objektin e IAAP “Selajdin Mullaabazi-Mici” në Rahovec dhe do të vazhdohet edhe në objekte të tjera shkollore të parapara sipas kontratës;
- Ka përfunduar mbajtja e Testit Ndërkombëtar PISA me nxënësit 15 vjeçarë;
- U realizuan dezinfektimi, dezinspektimi dhe deratizimi në të gjitha objektet arsimore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë;
- Mbajtëm një takim informues dhe koordinues me Forumin Anadrini (FARDI) për përgatitjet e fillimit të garës komunale për poezi, të vlefshme për çmimin “Xhevdet Bajraj”;
- U shënuan Dita e Shkollës në SHMU “Sadedin Hajda”, dhe në SHFMU “Sakip Bellaqa”;
- Ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë edhe në objektin SHFMU “Rilindja”;
- Në kuadër të projektit të riparimeve, kemi intervenuar dhe riparuar në disa elemente të sanitarisë në 2 objekte shkollore, në Xërxë dhe Ratkoc;
- Ka përfunduar procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e dytë për klasat 9, 10 dhe 11. Ndërkohë, nxënësit e klasave 1 deri 8 kanë mësim deri më 23 qershor 2025;
- Janë nënshkruar kontratat për studentët përfitues të bursës komunale;

- U shënuan Dita e Shkollës në SHFMU “Katër Dëshmorët”, në SHFMU “Sulejman Vokshi” dhe në SHFMU “Hamëz Thaçi” dhe në shkolla të tjera;
- Kemi pranuar raporte dhe statistika nga 32 shkollat e komunës tonë.
- Është mbajtur testi i Arritshërisë për klasat e 9-ta.
- Është mbajtur testi i Maturës afati i qershorit.

### Tremujori i tretë

- Është hapur konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasat e X-ta në ShML dhe IAAP të Komunës.
- Bazuar në obligimet e dalura nga MASHI-i për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore në kuader të këtyre obligimeve DKA me datë 14.07.2025 ka themeluar Komisionin për përpilimin e katalogjeve për tekste shkollore dhe pas përfundimit të përgatitjeve me datë 15.07.2025 ka hartuar katalogun me nr. 04/765 për tekste shkollore të nivelit 1-5.
- Janë hapur konkurse për lëndën e Gjeografisë, Gjuhës Gjermane, Matematikës, Biologjisë, Program Fillor, Fizikës, Artit Figurativ dhe Elektroteknikës. Të gjitha proceduarat janë përfunduar me kohë dhe janë pranuar kandidatët meritore në secilën lëmi.
- Janë përgatitur Vendime për pushime të lehonisë, për transfere të mësimdhënësve, për ndërprerje të marrëdhënies së punës si dhe për zëvendësim të mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore.
- Është shpallur afati i dytë për regjistrimin e nxënësve në klasat e X-ta.
- Është mbajtur testi Maturës afati i gushtit.
- Kemi pranuar statistika dhe raporte të gjendjes infrastrukturore të institucioneve Edukativo-Arsimore nga të gjithë drejtorët e shkollave.
- Bazuar në obligimet e DKA-së që dalin nga Ligji Nr. 04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068, për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Rregulloreve Komunale për organizimin e punës dhe mësimin në SHFMU-të dhe SHML-të, e komunës së Rahovecit, DKA ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2025/26.
- Gjatë muajit shtator janë organizuar puntori me OJQ të ndryshme në të cilat kanë qenë të përfshirë të gjithë drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore ku vlen të theksohet takimi me OJQ (Terres Des Homes).
- Në kuadër të monitorimit të procesit edukativo-arsimor kemi vizituar shkollat: SHFMU “Isa Boletini”, “Bekim Sylka”, “4 Dëshmorët”, “Tre Dëshmorët dhe SHFMU “Sapniqi”.

## Tremujori i katërt

- DKA ka pranuar një donacion nga Kompania SUPER VIVA, e cila ka dhuruar printer për të gjitha shkollat e komunës. Pajisjet janë pranuar dhe shpërndarë tek të gjitha shkollat sipas listës përkatëse.
- DKA ka realizuar një sërë aktivitetesh përgatitore në kuadër të mbështetjes dhe organizimit të konkursit të poezisë për Çmimin “Xhevdet Bajra”, një iniciativë kulturore e rëndësishme që synon promovimin e krijimtarisë letrare tek të rinjtë dhe nderimin e veprës së poetit Xhevdet Bajra – Fardi nga Anadrini.
- Më datë 30.10.2025 ka filluar dita e parë e Trajnimit të Mësimdhënësve për Zbatimin në Praktikë të KKK-së. Trajnimi u zhvillua në SHFMU “Isa Boletini”, nën udhëheqjen e trajnerëve Rrezart Veseli dhe Gani Kryziu, të cilët kanë punuar në dy grupe të veçanta. Në këtë trajnim po marrin pjesë 38 mësimdhënës të rinj. Po ashtu, duke filluar nga ora 13:00, në sallën e KKK-së së Rahovecit është mbajtur takimi me drejtorët e shkollave dhe koordinatorët shkollorë për sigurimin e cilësisë, ku janë diskutuar çështje me rëndësi për funksionimin dhe përmirësimin e proceseve mësimore dhe administrative.
- Që nga fillimi I muajit nëntor së bashku me stafin kemi zhvilluar vizita zyrtare në një numër të konsiderueshëm të institucioneve edukativo-arsimore.
- Më datë 25.11.2025 në sallën e KK të Rahovecit është mbajtur mbledhja konstituive e Këshillit të Prindërve në nivel komunal, ku edhe është bërë zgjedhja e Kryesisë së këtij Këshilli, ku kryetar u zgjodh Fidan Shala nga SHFMU “Haki Stërmilli” në Zoqishtë.
- Gjatë muajit dhjetor nën organizimin e DKA-Së është mbajtur takim pune me zyrtarët e MASHTI-t dhe me një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve të programit fillor nga klasa 1-5 ku janë diskutuar problematikat e furnizimit dhe cilësisë së teksteve shkollore në përdorim nga nxënësit e shkollave tona.
- Me datë 05.12.2025 është organizuar takim me OJQ “YMCA” dhe menagjmentin e IAAP “Selajdin Mullaabazi – Mici” rreth implementimit të projektit të UNDP-së me mësimdhënës dhe nxënës të kësaj shkolle.
- **Pastaj kemi edhe 11 indikatorët e performances komunale me 47 të dhëna si në vijim:**  
**Indikatori 14.1.1 Shkolla me masa të efijencës së energjisë për vitin 2024-2025 është 58.13%,**  
në këtë indikator kemi këto të dhëna:
  1. Numri i objekteve shkollave të nivelit parauniversitar ISCED 0-3, është 32,
  2. Numri i objekteve shkollore të nivelit parauniversitar të pajisura me sisteme të energjisë solare, është 0.
  3. Numri i objekteve shkollore të nivelit parauniversitar të pajisura me masa për kursim të energjisë, vetëm shkolla Gëzim Hamza Piktori furnizohet me rrymë, ndërsa shkollat tjera furnizohen me dru dhe pelet, kështu që numri i shkollave për kursim të energjisë është 31.
  4. Numri i objekteve shkollore të nivelit parauniversitar të pajisura me sisteme gjeotermale, është 0.

**Indikatori 14.1.2 Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar, është 100%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Numri i objekteve shollave në nivelin parauniversitar ISCED 0-3 është 32;
2. Numri i objekteve shkollore të nivelit parauniversitar të pajisura me sisteme të kamerave është 32;
3. Numri i objekteve shkollore të nivelit parauniversitar të pajisura me rrethoja të Objekteve, është 32;
4. Numrin e shkollave në nivelin parauniversitar, është 32;
5. Numrin e shkollave në nivelin parauniversitar të cilat kanë dorëzuar raportin përmbledhës në DKA 2 herë në vit, është 32;
6. Numri i raportimeve të KKSBB para kuvendit komunal, është 2 herë në vit.

**Indikatori: 14.1.3 - Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar, është 73.13%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Numri i objekteve shkollore të nivelit sipas ISCED 1.2 dhe 3 në menaxhimin e komunës, është 32.
2. Numri i objekteve shkollore të pajisura me sallë të edukatës fizike me mjete dhe pajisje, është 9.
3. Numri i objekteve shkollore të pajisura me kabinete(laboratorë punëtori), është 24.
4. Numri i objekteve shkollore të pajisura me bibliotekë të shkollës të pajisur dhe në funksion, është 20.
5. Numri i objekteve shkollore të pajisura me klasa të zakonshme të pajisura me orëndi të domosdoshme shkollore, është 32.
6. Numri i objekteve shkollore me klasa të zakonshme të pajisura me mjete elektronike për zhvillimin e aktivitetit mësimor(projektor tabela elektronike), është 32.

**Indikatori: 14.2.1 - Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës, është 45.48%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Gjithsej numri i mësimdhënësve në institucionet arsimore të nivelit ISCED 02 1 2 dhe 3, është 798.
2. Gjithsej numri i nxënësve në institucione arsimore të nivelit ISCED 02 1 2 dhe 3, është 7258.

**Indikatori: 14.3.1 - Fëmijë që vijnë kopshtin, është 32.88%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare në nivel të komunës, është 520.
2. Numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare në zonë rurale në komunë, është 312.
3. Numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare që vijnë kopshtin, është 171.
4. Numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare që vijnë kopshtin në zona rurale, është 48.
5. Numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare nga komuniteti jo shumicë që vijnë kopshtin (Kjo e dhënë mbledhet për analizë në raportin e performancës por nuk llogaritet në formulën e treguesit), është 0.

**Indikatori: 14.3.2 - Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta, është 59.05%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Rezultati i arritur në testin e arritshmërisë për klasat e 9-ta, është 59.05%. Në testin e arritshmërisë kanë marrë pjesë 569 nxënës, ku prej tyre 233 nuk kanë kaluar testin, ndërsa 336 kanë kaluar testin apo 59.05%.
2. Rezultati i arritur nga vajzat në testin e arritshmërisë për klasat e 9-ta, është 66.44%. Në testin e arritshmërisë kanë marrë pjesë 298 vajza, ku prej tyre 100 nuk kanë kaluar testin, ndërsa 198 kanë kaluar testin apo 66.44%.

**Indikator: 14.3.3 - Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë), është 56.45%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Numri i nxënësve të cilët kanë mbaruar klasën e 12-të, është 349.
2. Numri i nxënësve me rezultatu mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa e 12, është 197. Në afatin e qershorit kanë marrë pjesë 256 nxënës ku prej tyre kanë kaluar 133, ndërsa në afatin e gushtit kanë marrë pjesë 115 nxënës, ku prej tyre kanë kaluar 64 nxënës. Gjithsej 197 nxënës kanë kaluar testin e maturës.
3. Numri i nxënësve vajza të cilat kanë mbaruar klasën e 12-të, është 152.
4. Numri i nxënësve vajza me rezultate mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa e 12-të, është 109. Në afatin e qershorit kanë marrë pjesë 136 nxënës vajza ku prej tyre kanë kaluar 68, ndërsa në afatin e gushtit kanë marrë pjesë 63 nxënës vajza, ku prej tyre kanë kaluar 41 nxënës. Numri i nxënësve vajza që kanë kaluar testin e maturës është 109.

**Indikatori: 14.3.4 - Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse), është 100%, në këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. SHBK\_KI1, është 0, në klasën e I-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
2. SHBK\_KI2, është 0, në klasën e II-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
3. SHBK\_KI3, është 0, në klasën e III-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
4. SHBK\_K4, është 0, në klasën e IV-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
5. SHBK\_K5, është 0, në klasën e V-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
6. SHBK\_KI6, është 0, në klasën e VI-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
7. SHBK\_KI7, është 0, në klasën e VII-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
8. SHBK\_KI8, është 0, në klasën e VIII-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
9. SHBK\_KI9, është 0, në klasën e IX-rë, nuk kemi nxënës braktisës.
10. Numri i nxënësve nga komuniteti shumicë që e kanë braktisë (Kjo e dhënë mblidhet për analizë në raportin e performancës por nuk llogaritet në formulën e treguesit), është 5.
11. Numri i nxënësve nga komuniteti jo shumicë që e kanë braktisë shkollimin (Kjo e dhënë mblidhet për analizë në raportin e performancës por nuk llogaritet në formulën e treguesit), është 0.
12. Numri i nxënësve të gjinisë femërore që e kanë braktisë shkollimin (Kjo e dhënë mblidhet për analizë në raportin e performancës por nuk llogaritet në formulën e treguesit), është 2.

**Indikatori: 14.3.5 - Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit, është 97.63%, këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Gjithsej numri i orëve të planifikuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ISCED 1 2 dhe 3, është 456341.
2. Gjithsej numri i orëve të realizuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ISCED 1 2 dhe 3, është 445516.

**Indikator: 14.4.1 - Trajtimi i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga komisioni i DKA, është 100%, këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Numri i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta, është 1.
2. Numri i fëmijëve/nxënësve të cilët janë nënshtruar vlerësimit pedagogjik, është 1.

**Indikator: 14.4.2 - Shkalla e sigurimit të mbështetjes me pedagog - asistent ndihmës për fëmijët / nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta, është 92%, këtë indikator kemi këto të dhëna:**

1. Numri fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta deri në klasën e 12-të, është 50.
2. Numri i asistenteve për nxënës me nevoja të veçanta në klasat e rregullta në komunë në nivelet ISCED 1, 2, dhe 3, është 23.

faqe 9

